

“Lifelong Empowerment and Protection in Albania”
UN Joint Programme



**Udhërrëfyesi Rajonal për Zhvillimin e Aftësive dhe
Punësimin**

*Rrugët gjithëpërfshirëse drejt sektorit të hotelerisë dhe turizmit në bashkitë
Lezhë dhe Vorë*

Shtator 2025

Tabela e përmbajtjes

LISTA E SHKURTESAVE	3
PARATHËNIE	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1. KONTEKSTI DHE SFIDAT NË VEND	7
1.1. BASHKIA VORË	7
1.2. BASHKIA LEZHË	8
2. LINJAT E SHËRBIMIT TË UDHËRRËFYESIT	9
2.1. SHËRBIMET E MBULIMIT, AKTIVIZIMIT DHE TREGUT TË PUNËS	10
2.2. QASJA NË TRAJNIME DHE ZHVILLIM AFTËSISH	10
2.3. SHËRBIME KËSHILLIMI PËR SIPËRMARRJEN DHE BIZNESIN	10
2.4. QASJA NË FINANCIM	10
2.5. KRIJIMI I SHOQATAVE DHE RRJETËZIMI	10
3. PLANI I VEPRIMIT: NDËRHYRJET KRYESORE DHE DETAJET E ZBATIMIT	11
VEPRIMI 1: MBULIMI I KOMUNITETIT DHE AKTIVIZIMI I PARTNERITETIT PËR PUNËSIM	11
1.1. <i>Objektivi dhe synimi</i>	11
1.2. <i>Veprimet kyç dhe periudha e zbatimit</i>	12
1.3. <i>Përgjegjësitë</i>	12
1.4. <i>Produktet e pritshme</i>	13
VEPRIMI 2: ZGJERIMI I TRAJNIMIT PËR AFTËSITË GJITHËPËRFSHIRËSE PËR HOTELERINË DHE TURIZMIN	14
2.1. <i>Objektivi dhe synimet</i>	14
2.2. <i>Veprimet kyç dhe periudha e zbatimit</i>	14
2.3. <i>Përgjegjësitë</i>	15
2.4. <i>Produktet e pritshme</i>	16
VEPRIMI 3: FORCIMI I SHËRBIMEVE TË KËSHILLIMIT PËR KARRIERËN DHE PUNËSIMIT	16
3.1. <i>Objektivi dhe synimet</i>	16
3.2. <i>Veprimet kyç dhe periudhat e zbatimit</i>	16
3.3. <i>Përgjegjësitë</i>	17
3.4. <i>Produktet e pritshme:</i>	18
VEPRIMI 4: PROMOVIMI I SIPËRMARRJES GJITHËPËRFSHIRËSE DHE ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE TË TURIZMIT	18
4.1. <i>Objektivi dhe synimet</i>	18
4.2. <i>Veprimet kyç dhe periudha e zbatimit</i>	18
4.3. <i>Detyrimet</i>	20
4.4. <i>Produktet e pritshme</i>	21
VEPRIMI 5: SHFRYTËZIMI I FONDEVE DHE INFRASTRUKTURËS PËR RRITJEN E TURIZMIT GJITHËPËRFSHIRËS	21
5.1. <i>Objektivi dhe synimet</i>	21
5.2. <i>Veprimet kyç dhe periudha e zbatimit</i>	21
5.3. <i>Përgjegjësitë</i>	22
5.4. <i>Produktet e pritshme</i>	23
4. MASAT E ZBATIMIT	24
SHTOJCA 1. PËRMBLEDHJA E VEPRIMEVE	25

Lista e shkurtesave

MATP	Masa Aktive në Tregun e Punës
SHSHT	Shoqata Shqiptare e Turizmit
VKM	Vendimi i Këshillit të Ministrave (Dekret qeveritar)
ZP	Zyra e Punës (shërbim publik vendor punësimi)
HT	Hoteleri dhe Turizëm
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
PP	Program i Përbashkët
LEAP	<i>Fuqizimi dhe mbrojtja gjatë gjithë jetës</i> (Program i përbashkët i OKB-së)
Udhërrëfyesi	Udhërrëfyesi Rajonal për Zhvillimin e Aftësive dhe Punësimin
MAS	Ministria e Arsimit
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
NEET	Jo në punësim, arsim ose formim
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Parathënie

Udhërrëfyshi rajonal për zhvillimin e aftësive dhe punësimin (Udhërrëfyshi) për bashkitë Lezhë dhe Vorë paraqet një strategji të unifikuar për të nxitur punësimin, zhvillimin e aftësive dhe përfshirjen sociale, përmes sektorit të hotelerisë dhe turizmit (HT). Ai është hartuar në kuadër të programit të përbashkët të OBK-së “Fuqizimi dhe mbrojtja gjatë gjithë jetës” (LEAP) me mbështetjen teknike të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Udhërrëfyshi përputhet ngushtësisht me Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023–2030, Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje Sociale 2024–2030 dhe Strategjinë Kombëtare për Turizmin 2024–2030, duke garantuar përforcim të synimeve kombëtare të politikave përmes veprimeve vendore.

Përgatitja e këtij Udhërrëfyshi është përpjekje bashkëpunuese. Bashkitë Lezhë dhe Vorë kanë ofruar udhëheqje dhe vizion për identifikimin e sfidave dhe mundësive në vend. Falënderojmë Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) për udhëzimet e saj mbi harmonizimin e Udhërrëfyshit me kuadrot kombëtarë. Institucionet e arsimit profesional, bizneset, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë vendorë (përfshirë përfaqësuesit e punëdhënësve dhe punonjësve) dhanë kontribute të vlefshme. U shprehim mirënjohje të gjitha palëve të interesit për angazhimin e tyre në promovimin e rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe punës dinjitoze në Lezhë dhe Vorë.

Falënderojmë përzemërsisht për kontributet e tyre Znj. Gertiola Cepani, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve të Tregut të Punës në AKPA dhe Znj. Jonida Lika, Përgjegjëse e Sektorit të Garancisë Rinore dhe Projekteve në AKPA, Z. Bardh Dedgjoni, Drejtor i shkollës profesionale “Kolin Gjoka” në Lezhë dhe Znj. Rudina Gjoka, mësuese në të njëjtin institucion, Z. Luigj Gjergji, Drejtor i shkollës profesionale “Shën Jozefi Punëtor” në Rrëshen, Znj. Marte Fetaj, Përgjegjëse e Departamentit të Asistencës Sociale në Bashkinë Lezhë, Znj. Etleva Jaku nga Zyra e Punës në Lezhë, Z. Zak Topuzi, Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Turizmit (SHSHT). Së bashku, dhanë kontribute me vlerë për lidhjen e zhvillimit të turizmit me krijimin e vendeve të punës dhe sipërmarrjen. Ky udhërrëfyshi u hartua me ndihmën e z. Kastriot Sulka.

Kutiza 1. Projekti LEAP Shqipëri - Fuqizimi dhe mbrojtja gjatë gjithë jetës në Shqipëri

LEAP-i është një program i përbashkët i Qeverisë Shqiptare, që së bashku me UNDP-në, UNICEF-in dhe ILO-n, synon zhvillimin e një sistemi të përgjigjshëm dhe gjithëpërfshirës të mbrojtjes sociale për mbështetjen e individëve gjatë ciklit të tyre të jetës. PP-ja organizohet në dy rezultate të pritshme të ndërlydhura. Si fillim, PP-ja do të zgjerojë mbulimin e mbrojtjes sociale, duke integruar sistemet për rritjen e cilësisë dhe qasjen e fëmijëve dhe familjeve në shërbime. Kjo përpjekje përfshin vënien në zbatim të përfitimit universal të fëmijës dhe të strategjive të menaxhimit të kujdesit të integruar. Së dyti, PP-ja synon rritjen e punësimit për përfituesit e asistencës sociale duke përmirësuar qasjen në punë dinjitoze përmes punësimit të synuar dhe të integruar dhe nismave për zhvillimin e aftësive. Kjo kërkon përqendrim të konsiderueshëm të ofrimi i punësimit të integruar dhe mbështetjes për zhvillimin e aftësive dhe riaftësimin, veçanërisht në sektorë si hoteleria dhe turizmi, si dhe zgjerimi i mundësive për punë dinjitoze dhe sisteme të sigurimeve shoqërore për punonjësit sezonalë.

Ky program i përbashkët mbështetet nga Fondi i Përbashkët i OZHQ-ve, me kontribute nga Bashkimi Evropian dhe qeveritë e Belgjikës, Danimarkës, Gjermanisë, Irlandës, Italisë, Luksemburgut, Monakos, Vendeve të Ulëta, Norvegjisë, Polonisë, Portugalisë, Republikës së Koresë, Arabisë Saudite, Spanjës, Suedisë dhe Zvicrës për përkrahjen e përpjekjeve të arritjes së OZHQ-ve.

Përmbledhje ekzekutive

Bashkia Lezhë dhe Bashkia Vorë në Shqipëri, dy bashki me profile të ndryshme, janë bërë bashkë për të krijuar një Udhërrëfyes rajonal për zhvillimin e aftësive dhe punësimin (Udhërrëfyesi), që shfrytëzon potencialin e sektorit të hotelierisë dhe turizmit për krijimin e vendeve të punës dhe nxitjen e përfshirjes sociale. Ky Udhërrëfyes paraqet një qasje të synuar të bazuar në evidenca për trajtimin e sfidave të tregut të punës në të dyja bashkitë, që nga mospërputhjet e aftësive dhe papunësia e të rinjve, deri te pabarazitë gjinore dhe përfshirja e grupeve të marginalizuara, përmes veprimeve të koordinuara vendore. Ky model do të pilotohet me mbështetjen e projektit “LEAP” për të siguruar bazën për replikim të mundshëm në bashki të tjera në Shqipëri.

Sektori i turizmit në Shqipëri përballët me sfida strukturore, duke përfshirë mospërputhjen ndërmjet aftësive të mbështetura nga institucionet e trajnimit dhe nevojat e punëdhënësve, modelet e punësimit sezonal dhe interesin e kufizuar të punëkërkuesve si pasojë e kushteve të paqëndrueshme të punës. Këto sfida përkeqësohen nga pabarazitë gjinore. Gratë, veçanërisht ato që largohen nga industritë në të tekstileve dhe këpucëve (TVLK), hasin pengesa si detyrat e përkujdesjes dhe mungesa e mundësive për riaftësim. Përfituesit e ndihmës ekonomike, të rinjtë NEET, komunitetet romë dhe egjiptiane, si dhe personat me aftësi të kufizuara përballen me integrim të dobët në punësimin formal. Në Vorë, në zonën periurbane pranë Tiranës, afërsia me zonat industriale dhe qendrat e transportit nuk është përkthyer në punësim të mjaftueshëm për banorët vendas, pjesërisht për shkak të nënshfrytëzimit të formimit profesional dhe lidhjeve të pamjaftueshme ndërmjet punëkërkuesve dhe ndërmarrjeve. Në Lezhë, në qarkun e pasur me asete turistike, papunësia e lartë kronike dhe niveli i ulët arsimor kanë kufizuar aftësitë e vendasve për të përfituar nga rritja në sektorin e hotelierisë. Kështu, të dyja bashkitë përballen me sfidën e dyfishtë të stimulimit të kërkesës për punë në sektorë të rinj ose në rritje (si hoteleria dhe turizmi), teksa përgatisin dhe lidhin më mirë fuqinë punëtore vendase, veçanërisht grupet e cenueshme, me këto mundësi.

Pavarësisht nga këto sfida, Lezha dhe Vora zotërojnë asete unike të cilat do të bazohet Udhërrëfyesi. Lezha ka një vijë bregdetare (Shëngjin) me një industri hotelerie në zhvillim, site të trashëgimisë kulturore (si Kalaja e Lezhës dhe Memoriali i Skënderbeut) dhe bazë të fortë agroushqimore që mund të furnizojë ndërmarrjet e turizmit dhe gastronomisë. Vora ka një vendndodhje strategjike përgjatë korridorit Tiranë-Durrës dhe pranë Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, me një sektor industrial dhe logjistik në rritje dhe potencial të pashfrytëzuar për turizëm njëditor, duke pasur parasysh atraksionet e saj natyrore dhe historike (si Kalaja e Prezës dhe shpellat në afërsi). Të dyja zonat kanë edhe burime institucionale: ofrues publikë dhe privatë të AFP-së në bashki ose pranë tyre dhe interes nga OJQ-të dhe bizneset vendase për të bashkëpunuar për zhvillimin e fuqisë punëtore. Këto pika të forta krijojnë bazën për një qasje të integruar ku përmirësimi i aftësive dhe përfshirja shoqërojnë nxitjen e turizmit të qëndrueshëm dhe industrive të tjera të lidhura me të. Udhërrëfyesi u orientua nga një proces vlerësimi me pjesëmarrje, i cili përfshiu shqyrtimin e analizave të disponueshme për të dyja bashkitë, konsultimet e thelluara me palët e interesit dhe shqyrtimet e të dhënave socio-ekonomike. Fokus grupet vendore u organizuan me të rinj, gra, komunitetin rom dhe persona me aftësi të kufizuara për identifikimin e pengesave në punësim dhe këmbimin e ideve për zgjidhje më 13.05.2025 në Lezhë dhe më 14.05.2025 në Vorë. Përfaqësues të qeverisë dhe sektorit privat u angazhuan përmes workshop-eve për të verifikuar gjetjet dhe për të përmirësuar veprimet e rekomanduara më 17.06.2025 në Lezhë.

Si rezultat u krijuan një sërë ndërhyrjesh të përshtatura për Lezhën dhe Vorën, të shoqëruara me një afat kohor zbatimi dhe një plan monitorimi. Ndonëse bazohet në realitetin e vendit, qasja mbështetet

në analizën e OECD-së sa u përket faktorëve nxitës të krijimit të suksesshëm të vendeve të punës në nivel vendor, veçanërisht, qeverisjes së fortë me shumë palë interesi, programeve të synuara të aktivizimit dhe përafrimit të ofertës së aftësive me kërkesën e tregut¹.

Udhërrëfyesi për Lezhën dhe Vorën paraqet një grup prej **pesë linjash plotësuese shërbimi** dhe një plan veprimi të detajuar me ndërhyrje të ndërlidhura. Ai thekson partneritetin gjithëpërfshirës dhe “bashkëprodhimin” e zgjidhjeve nga autoritetet vendore, shërbimin e punësimit, ofruesit e trajnimeve, bizneset dhe organizatat komunitare.

Kutiza 2. Pesë linja plotësuese shërbimi

Linja 1 e shërbimit: mbulimi dhe aktivizimi, e drejtuar nga AKPA-ja me mbështetje nga bashkitë dhe organizatat e shoqërisë civile, përqendrohet në identifikimin e punëkërkuarve aktivë dhe të disavantazuar, duke u ofruar këshillim dhe duke i lidhur me mundësi trajnimi dhe punësimi.

Linja 2 e shërbimit - trajnimi dhe zhvillimi i aftësive, e koordinuar nga AKPA-ja dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) me ofrues publikë dhe privatë trajnimi, zgjeron kurset profesionale, trajnimin e dyfishtë dhe programet e zhvillimit të aftësive, që lidhen drejtpërdrejt me nevojat e tregut të punës dhe kërkesën e punëdhënësve.

Linja 3 e shërbimit - këshillimi për karrierën dhe shërbimet e punësimit, e zbatuar në shkollë me Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë përgjegjëse për AFP-në dhe e ofruar në shkollat e mesme të përgjithshme dhe shkollat e AFP-së dhe zyrat vendore të punës, ndihmon të rinjtë dhe punëkërkuarët në zgjedhjet e tyre për karrierën dhe qasjen në vende dinjitoze pune përmes këshillimit, përputhjes me vendin e punës dhe menaxhimin e përmirësuar të rasteve.

Linja 4 e shërbimit - sipërmarrja dhe mbështetja gjithëpërfshirëse e bizneseve, e nxitur nga bashkitë së bashku me Shoqatën Shqiptare të Turizmit, Dhomat e Tregtisë dhe institucionet mikrofinanciare, fuqizon sipërmarrësit vendas, veçanërisht gratë dhe të rinjtë për të hapur ose zhvilluar biznese dhe për të krijuar produkte turistike me bazë komunitare, që krijojnë vende pune në nivel vendor.

Linja 5 e shërbimit - rrjetëzimi dhe krijimi i partneriteteve, e drejtuar nga bashkitë me ministrinë kombëtare dhe partnerët donatorë, nxit grupet turistike dhe partneritetet publike-private, teksa mobilizon fonde dhe përmirëson infrastrukturën për të siguruar qëndrueshmëri dhe ndikim afatgjatë.

Përmes këtyre ndërhyrjeve, Udhërrëfyesi synon të krijojë **sinergji të forta mes ofertës së aftësive dhe krijimit të vendeve të punës**. Me anë të koordinimit të përmirësuar, krijimit të partneriteteve dhe rrjetëzimit, Lezha dhe Vora sigurojnë që shumë aktorë (bashkitë, AKPA-ja, qendrat e AFP-së, OJQ-të dhe sektori privat) punojnë së bashku drejt synimeve të përbashkëta të këtij Udhërrëfyesi.

Gjatë periudhës së zbatimit të këtij Udhërrëfyesi (12 muajt e ardhshëm, me përcaktimin e bazave për planin afatgjatë), Lezha dhe Vora synojnë arritjen e rezultateve konkrete në punësim dhe përfshirje. Partnerët kanë detajuar pesë veprime kyç në Udhërrëfyes, që pritet të angazhojë mbi 500 individë të papunë ose joaktivë në masa aktivizimi dhe trajnimi dhe të lehtësojë zhvillimin e aftësive ose riaftësimin e të paktën 200 personave në sektorin e turizmit. Përmes këtyre përpjekjeve, Udhërrëfyesi do të kontribuojë në uljen e papunësisë, veçanërisht të të rinjtë dhe gratë dhe do të forcojë përfshirjen sociale duke siguruar që grupet e cënueshme të mos mbeten pas, por të fuqizohen për pjesëmarrje në zhvillimin vendor dhe përfitim prej tij.

¹ Programi LEED i OECD-së për Aftësitë dhe Punësimin në Nivel Vendor, përditësuar për herë të fundit më 20 qershor 2025

1. Konteksti dhe sfidat në vend

1.1. Bashkia Vorë

Vora është një bashki e vogël me rreth 39.000 banorë, me vendndodhje strategjike mes Tiranës (16 km largësi) dhe Durrësit (18 km largësi). Gjithashtu, përfshin vendbanime në periferi dhe zonat rurale si Bërxulla dhe Preza. Vora, me një sipërfaqe prej 82.9 km², shtrihet përgjatë korridorit kryesor të transportit të Shqipërisë dhe vetëm 9 km larg Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës. Këto avantazhe gjeografike kanë siguruar investime në industrinë e lehtë, qendrat logjistike, komplekset tregtare, hotelet dhe restorantet, si dhe institucionet arsimore në Vorë e përreth. Ekonomia vendase deri më tani është karakterizuar nga një profil industrial dhe shërbimesh, me 1175 biznese private të regjistruara (duke përfshirë rreth 463 firma të mëdha/mesme dhe 712 ndërmarrje të vogla). Kjo bazë ekonomike ofron shumë mundësi për punësim; megjithatë, oferta dhe kërkesa vendase e punës nuk janë harmonizuar ende në mënyrë optimale.

Vora përfiton nga afërsia me ofrues të shumtë të arsimit profesional dhe të lartë. Një shkollë profesionale publike në Kamëz ofron kurse në Hoteleri dhe Turizëm, dhe Instituti privat i Kulinarisë “Neraxhi” (brenda 10 km) i aftëson studentët në arte kulinarë, menaxhim hotelerie dhe profesione të lidhura me to. Për më tepër, kryeqyteti i Tiranës, që nuk është shumë larg, ka qendra publike të formimit profesional (si Qendra e Formimit Nr. 1 dhe Nr. 4) dhe një shkollë të njohur për Hoteleri dhe Turizëm, ndërsa Durrësi (21 km larg) ka qendrën e vet publike të AFP-së dhe shkollën profesionale “Hysen Çela” të specializuar në turizëm. Gjithashtu, banorët e Vorës mund të kenë qasje në trajnime të personalizuar përmes universiteteve private në periferi të Tiranës (si Universiteti Polis, Universiteti Epoka etj.), që kanë kapacitetet për të ofruar kurse të shkurtra të personalizuar. Pavarësisht mundësive të shumta për formim, numri i regjistrimeve të Pulis rinjve të Vorës në arsimin profesional dhe teknik mbetet i ulët.

Përqindja e papunësisë në Vorë nuk raportohet zyrtarisht veçmas (meqenëse përfshihet në statistikat e qarkut Tiranë), por vëzhgimet vendore paraqesin nivel relativisht të ulët të regjistrimeve të papunësisë dhe numrin më të ulët të familjeve përfituese të asistencës sociale në rrethin Tiranë (ku vetëm rreth 50 familje në Vorë marrin ndihmë ekonomike). Kjo sugjeron një popullatë përgjithësisht më të mirë krahasuar me bashkitë e tjera. Megjithatë këto shifra mund të fshehin një sërë cenueshmërisht: p.sh., disa grupe, si minoriteti rom ose gratë që jetojnë në fshatra peri-urbane, hasin pengesa për qasjen në vende pune formale për shkak të nivelit të ulët arsimor ose përgjegjësisë për përkujdesje. Ndërkohë, punëdhënësit në Vorë raportojnë boshllëqe të vazhdueshme në aftësi, veçanërisht në sektorët e prodhimit dhe logjistikës që mbizotërojnë në zonë. Sipas një vlerësimi të fundit të nevojave për aftësi, 51% e bizneseve në zonën e Vorës hasin vështirësi në gjetjen e kandidatëve me aftësitë e kërkuara teknike dhe aftësi të përshtatshme joteknike (si shërbimi ndaj klientit ose puna në grup). Edhe pse paradoksale, shumë punëkërkues mbeten të papunë ose të punësuar nën nivelin e aftësive të tyre, gjë që tregon se ka mospërputhje dhe mangësi në informim.

Ekonomia e Vorës nuk e ka shfrytëzuar ende si duhet hotelerinë dhe turizmin. Vetëm 3,3% e bizneseve të regjistruara në zyrën vendore të punës janë në kategorinë **“Akomodim dhe shërbim ushqimor”**, që përbën përqindjen më të ulët midis rretheve të krahasueshme (për shembull, në Durrës ky sektor përbën rreth 12% dhe në Vlorë 25% të bizneseve të regjistruara). Kjo tregon një mundësi për të zhvilluar ndërmarrje turistike në Vorë. Pasuritë natyrore dhe kulturore të rajonit, si **Kalaja e Prezës** (një kala historike me pamje panoramike) dhe një sërë shpellash unike në kodrat përreth (si Shpella e Pëllumbasit dhe “Shpella e Mirë” dhe “Shpella e Mbytyes” pranë Shën Gjergjit), janë kryesisht të

pashfrytëzuara për ekoturizëm ose turizëm kulturor. Zhvillimi i këtyre atraksioneve mund të krijojë vende pune në nivel vendor në shërbimet e guidave, hotelierisë dhe transportit. Megjithatë, për ta realizuar këtë nevojitet mobilizimi i investimeve dhe aftësive, si dhe **angazhimi i komuniteteve vendase** për pjesëmarrje (për shembull, organizimi i tureve me guidë në shpella ose festivaleve kulturore).

1.2. Bashkia Lezhë

Lezha është bashki dhe qendër rrethi në veriperëndim të Shqipërisë, e njohur për historinë e saj të pasur dhe gjeografinë e larmishme, që përfshin zonat bregdetare, urbane dhe rurale. Bashkia (duke përfshirë qytetin e Lezhës dhe komunitetet përreth) përballet me **një nga nivelet më të larta të papunësisë në vend**, duke pasqyruar sfidat e thella të tregut të punës. Treguesit kryesorë të punës paraqesin seriozitetin e problematikës: në rrethin e Lezhës ka afërsisht 3550 kërkues të papunë të regjistruar, **57% e të cilëve janë gra**. Shumica e individëve të papunë (54%) kanë vetëm arsimin bazë dhe vetëm rreth 5% kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional, duke treguar *bazë të ulët të aftësive të përgjithshme*. Ky nivel i ulët arsimor është edhe shkak edhe pasojë e papunësisë: prej mundësive të kufizuara të punëve në vend, pasi kërkohen aftësi më të përparuara, shumë prej tyre nuk ndjekin trajnime të mëtejshme; megjithatë, pa aftësi, investimet e reja në zonë hasin vështirësi në gjetjen e stafit të kualifikuar dhe shpesh importojnë punonjës nga rajone të tjera.

Të rinjtë në Lezhë përballen me vështirësi të veçanta. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve (15-29 vjeç) janë **NEET**, pra, jo në punësim, arsim ose formim. Ndonëse nuk ka një përqindje të saktë për Lezhën, mendohet që shifra të jetë shumë më e lartë se mesataret në nivel kombëtar, duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë së të rinjve të raportuar gjatë konsultimeve. Të rinjtë që janë të punësuar ose në kërkim të një punë përballen me problematikën e **mospërputhjes së aftësive**: përlogaritjet që rreth 40% e punonjësve në qarkun Lezhë të jenë të mbikualifikuar ose nënkualifikuar për vendet aktuale të tyre të punës. Kjo gjë pasqyron një prirje më të gjerë në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor, ku rezultatet e arsimit dhe kërkesat për vendet e punës kanë mospërputhje. Punëdhënësit në Lezhë raportojnë vështirësi në plotësimin e vendeve të lira të punës në fusha të caktuara në rritje si teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe hoteleria e nivelit të lartë, sepse shumë punëkërkues nuk kanë aftësitë specifike teknike ose digjitale. Po ashtu, ka të rinj me arsim universitar që punojnë në vende pune ku nuk i shfrytëzojnë plotësisht kualifikimet e tyre (ose punojnë në mënyrë informale), duke treguar se ka nënpunësim. Kjo mospërputhje thekson nevojën për **programe trajnimi dhe këshillim për karrierën të modernizuara** për t'i orientuar më mirë të rinjtë drejt aftësive që u nevojiten realisht punëdhënësve.

Përfshirja sociale është shqetësim kritik në Lezhë. Shërbimet sociale shtetërore kanë klasifikuar 426 familje në rreth si *tejet të varfra*, gjë që tregon se ka zona me privim të rëndë (veçanërisht në fshatrat rurale në zona të thella). Nga individët e regjistruar si të papunë, **226 janë nga komunitetet minoritare rome dhe egjiptiane**, 43,6% e të cilëve janë gra. Këto komunitete përballen me pengesa të shumta, përfshirë nivelin e ulët arsimor, diskriminimin e në shumë raste mbështetjen e puna informale ose sezonale për të përballuar jetesën. Qasja në shërbimet publike për individët e cenueshëm është e kufizuar. Vlerësimet e fundit tregojnë se mbrojtja sociale dhe programet e punësimit mbulojnë vetëm **2-3% të individëve në nevojë** në qarkun Lezhë, e për rrjedhojë pjesa më e madhe e personave të varfër nuk marrin mbështetje të mjaftueshme. Edhe gratë në Lezhë përjetojnë disavantazhe të shumfishta: ato mbi 45 vjeç, që mund të humbasin vendet e punës në fabrikat e tekstilit/veshjeve të cilat janë në tkurrje, hasin vështirësi për të rihyrë në fuqinë punëtore për shkak të paragjyimeve për moshën,

mungesës së aftësive alternative dhe shpesh detyrave të kujdesit familjar (në mungesë të shërbimeve të kujdesit për fëmijët). Të rejat, veçanërisht në zonat rurale, mund të ngurrojnë lidhur me trajnimet profesionale ose punësimin formal për shkak të roleve tradicionale gjinore dhe shqetësimeve për sigurinë gjatë udhëtimit për në punë.

Në qytetin e Lezhës ndodhen site të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë **Kalanë e Lezhës** në majë të kodrës, me pamje panoramike dhe rëndësi historike dhe **Mauzoleun (Memorialin) e Skënderbeut**, i cili përkujton heroin kombëtar të Shqipërisë dhe tërheq vizitorë gjatë gjithë vitit. Historia ilire, veneciane dhe osmane e rajonit vihet re në arkitekturën, arkeologjinë dhe traditat vendase. Këto pasuri kulturore janë ideale për zhvillimin e tureve me guidë, turizmit edukativ për studentët dhe aktivitetet kulturore që kremtojnë historinë vendase. Megjithatë, për momentin, këto site janë të nënpromovuara dhe kanë një numër të kufizuar ambientesh për vizitorët.

Vija bregdetare e Lezhës, veçanërisht qyteti i **Shëngjinit** (afërsisht 7 km nga qyteti i Lezhës), ka një sektor turizmi në rritje me hotele, restorante dhe infrastrukturë plazhi të reja. Plazhet e Shëngjinit tërheqin turistë vendas dhe një sërë vizitorësh të huaj gjatë verës, numri i të cilëve është në rritje. Në sipërfaqe tokësore, rrethi ofron peizazhe rurale piktoreske dhe zona të mbrojtura. Për shembull, laguna Kune-Vain dhe malet përreth, të cilat janë të përshtatshme për ekoturizëm, ecje në natyrë dhe agroturizëm. Gjithashtu, në Mirditë dhe në pjesë të tjera të rrethit të Lezhës ka atraksione natyrore unike (shpella, ujëvara etj.), që mbeten kryesisht të pashfrytëzuara për turizëm. Zhvillimi i **modeleve alternative të turizmit** (si qëndrimi në ferma, shtigjet natyrore dhe bujtinat kulturore) mund të krijojë vende të tjera pune krahas punëve sezonale të hotelerisë në bregdet dhe të ndihmojë në përfshirjen e fshatrave në zinxhirin e vlerës së turizmit.

Lezha ka një traditë të fortë bujqësore, me prodhime deti (falë qasjes në Adriatik), produkte bulmeti dhe mishi, fruta, perime dhe verë. Kjo krijon mundësi për **turizmin kulinar** dhe sipërmarrjet nga ferma në tryezë. Një histori e shënuar suksesi në qark është restoranti “Mrizi i Zanave” në Fishtën e afërt, i cili është bërë i famshëm për filozofinë “slow food” (ushqim i ngadaltë) dhe përdorimin e produkteve ekskluzivisht vendase. Modeli i Mrizit të Zanave tregon se si investimi në cilësi, origjinalitet dhe zinxhirë furnizimi vendorë mund të nxisë krijimin e vendeve të punës në zonat rurale. Restoranti merr prodhime nga dhjetëra fermerë vendas, duke u siguruar të ardhura të qëndrueshme për familjet e tyre dhe ka frymëzuar bizneset e reja në zonë. Replikimi i modeleve të tilla (p.sh., mbështetja e krijimit të bujtinave të agroturizmit ose workshop-eve të përpunimit të ushqimit të drejtuar nga sipërmarrës vendas) është mundësi kyç për Lezhën.

Vendndodhja e Lezhës është e favorshme edhe për tregtinë. Porti i Shëngjinit ofron një port detar të vogël, por në rritje, i cili jo vetëm mbështet turizmin (lidhje tragetesh, potencial për lundrim), por mund të shndërrohet edhe në një qendër për tregtime vendet fqinje (veçanërisht si një portë hyrëse për tregun e Kosovës). Bashkia ndodhet përgjatë korridoreve kryesore rrugore që lidhin vendin me Kosovën dhe Malin e Zi. Me anë të investimeve të duhura në logjistikë, objekte përpunimi dhe marketing, Lezha mund të tërheqë biznese që përfitojnë nga tregtia ndërkufitare dhe fluksi i turistëve midis bregdetit dhe atraksioneve në sipërfaqe tokësore.

2. Linjat e shërbimit të udhërrëfyesit

Veprimet në këtë Udhërrëfyes bazohen në pesë linja shërbimesh plotësuese dhe të ndërlidhura. Këto linja shërbimesh ofrojnë një kuadër për organizim veprimtarish dhe sigurim që ndërhyrje të ndryshme të lehtësojnë së bashku krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e aftësive dhe kalimin në punësim formal për grupet e synuara në Lezhë dhe Vorë:

2.1. Shërbimet e mbulimit, aktivizimit dhe tregut të punës

Identifikimi dhe angazhimi i individëve joaktivë ose të disavantazhuar (si të rinjtë NEET, gratë e papuna afatgjata, romët dhe pakicat e tjera, personat me aftësi të kufizuara) kombinohet me masat e aktivizimit. Këtu përfshihen fushatat për mbulim komuniteti, këshillimi individual dhe referimi në zyrat e punës ose programe mbështetëse. Kështu, forcohen shërbimet publike të punësimit (përfshirë zyrat vendore të punës) për të zgjeruar mbulimin e komuniteteve dhe për të ofruar ndihmë të përshtatur (duke përfshirë udhëzime për kërkimin e punës, profilizimin e punëkërkuesve për MAPT-të etj.).

2.2. Qasja në trajnime dhe zhvillim aftësish

Zgjerimi i ofertës dhe shfrytëzimi i mundësive të trajnimit cilësor, që lidhen drejtpërdrejt me nevojat e tregut. Kjo linjë shërbimi mbulon kurset formale të AFP-së, formimin profesional afatshkurtër, trajnimin në vendin e punës dhe programet e riaftësimit dhe aftësimit. Këtu përfshihet modernizimi i kurrikulave (në partneritet me industrinë), përmirësimi i mjediseve për trajnim (duke përfshirë qasjen në pajisjet ose teknologjinë e nevojshme) dhe përfshirja e ofruesve privatë të trajnimit ose OJQ-ve për të plotësuar trajnimin publik. Ajo që synohet është sigurimi që trajnimi fleksibël dhe i bazuar në kompetenca të jetë i disponueshëm për hotelerinë, turizmin, TIK-un, aftësitë gjuhësore dhe fushat e tjera të kërkuara. Nismat e veçanta në kuadër të kësaj linje përfshijnë skema trajnimi të dyfishtë (duke kombinuar përvojën teorike dhe praktike) dhe njohjen e të nxënësve të mëparshëm për punonjësit me përvojë informale.

2.3. Shërbime këshillimi për sipërmarrjen dhe biznesin

Mbështetje për sipërmarrësit potencialë dhe ndërmarrjet mikro/të vogla ekzistuese për të krijuar dhe zgjeruar bizneset që gjenerojnë punësim në vend. Sipas kësaj linje, Udhërrëfyesi ofron trajnime për sipërmarrjen, mentorim për planifikimin e biznesit. Ai u jep përparësi ndërmarrjeve me potencial të lartë për krijimin e vendeve të punës ose atyre që adresojnë nevojat vendore (për shembull, startup-et në turizëm, agrobiznesi, produktet e artizanatit ose industritë krijuese). Gratë dhe të rejtat sipërmarrëse marrin vëmendje të veçantë për t'u siguruar se kanë qasje në këto shërbime.

2.4. Qasja në financim

Lehtësimi i ofrimit të mbështetjes financiare (grante të vogla, mikrokredi ose bashkëfinancim) për grupe ose individë të papunë që hapin biznese, si dhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ekzistuese që angazhohen për të krijuar vende pune ose për të formalizuar punonjësit informalë. Kjo linjë shërbimi punon në bashkëpunim me programet kombëtare (si skemat mbështetëse të AKPA-ja ose fondet e zhvillimit të bujqësisë dhe turizmit) për të kanalizuar burimet në Lezhë dhe Vorë. Ajo mund të përfshijë krijimin e skemave të granteve për bizneset e reja, ndihmën ndaj bizneseve në përgatitjen e aplikimeve për kredi ose lidhjen e tyre me institucionet e mikrofinancimit. Qasja në financim është thelbësore për vënien në zbatim të idetë për biznes (të zhvilluara përmes Linjës 2 të Shërbimit) dhe për mundësimin e investimeve në pajisjet ose infrastrukturën e nevojshme.

2.5. Krijimi i shoqatave dhe rrjetëzimi

Nxjitja e krijimit dhe forcimit të rrjeteve dhe shoqatave vendore që mbështesin rezultatet e punësimit. Këtu përfshihet krijimi i partneriteteve të tilla si grupet vendore të turizmit (që bashkojnë hotele, restorante, operatorë turistikë, fermerë dhe artizanë për të zhvilluar produkte dhe marketing të përbashkët) dhe komitete publike-private. Përmes ngritjes së shoqatave, palët e interesit bashkojnë burimet dhe njohuritë, angazhohen në advokim kolektiv dhe sigurojnë qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve përtej periudhës kohore të projektit. Sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve janë aktorë kyç në këtë linjë shërbimesh, duke ndihmuar në formalizimin e vendeve të punës dhe promovimin e standardeve të punës dinjitoze në sektorë të rinj ose në rritje.

Të gjitha veprimet në Udhërrëfyes janë hartuar për të përdorur një ose më shumë nga linjat e shërbimit të mësipërme në kombinim. Kështu, Udhërrëfyesi siguron që përmirësimet në një fushë të përforcohen nga masa plotësuese në fusha të tjera. Qasja e integruar maksimizon ndikimin në qëllimet gjithëpërfshirëse të krijimit të vendeve të punës, përmirësimit të aftësive, formalizimit të punës dhe përfshirjes sociale.

3. Plani i veprimit: Ndërhryjet kryesore dhe detajet e zbatimit

Në seksionin në vijim paraqitet Plani i Veprimit për Lezhën dhe Vorën, i strukturuar si seri veprimesh specifike. Çdo veprim përshkruhet me arsyetimin dhe përfshin detajet kyç:

- ▶ **Objektivat dhe synimet** (qëllimi kryesor i veprimit; synimet e shprehura në terma sasiorë ose përfituesit),
- ▶ **Veprimet kyç dhe periudha e zbatimit** (periudha e zbatimit),
- ▶ **Përgjegjësitë e partnerëve drejtues dhe të partnerëve të tjerë përgjegjës** (institucionet përgjegjëse dhe aktorët mbështetës), dhe
- ▶ **Produktet e pritshme** (rezultate të prekshme ose rezultate të Veprimit).

Veprimet janë të ndërlidhura dhe të renditura për zhvillim të vazhdueshëm. Veprimet e hershme hedhin themelet (përmes shtrirjes së veprimtarive dhe vlerësimeve), ndërsa veprimet e mëvonshme ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta dhe zgjidhje afatgjata. Së bashku, ato adresojnë sfidat e identifikuar dhe shfrytëzojnë mundësitë vendore për punësim në sektorët e hotelierisë dhe turizmit.

Veprimi 1: Mbulimi i komunitetit dhe aktivizimi i partneritetit për punësim

1.1. Objektivi dhe synimi

Synohet nisja e zbatimit të Udhërrëfyesit përmes identifikimit të palëve të interesit, krijimit të partneriteteve vendore dhe mbledhjes së informacionit bazë mbi nevojat e punëkërkuesve dhe punëdhënësve në sektorin e HT-së. Ky Veprim hedh themelet për planifikim gjithëpërfshirës, duke siguruar që ndërhyrjet të jenë të orientuara drejt komunitetit dhe që të gjithë aktorët përkatës të jenë të angazhuar që nga fillimi.

Në fund të këtij Veprimi, do të hartohet një hartë gjithëpërfshirëse e palëve të interesit dhe të paktën 100 individë nga grupet e cënueshme (gra, të rinj, romë/egjiptianë, persona me aftësi të kufizuara) do të konsultohen përmes fokus grupeve ose intervistave. Të paktën 30 institucione/organizata vendore (departamente bashkiake, biznese, OJQ, ofrues trajnimesh, udhëheqës të komunitetit) do të përfshihen në dialogun e partneriteteve. **(Linjat 1 dhe 5 të shërbimit)**

1.2. Veprimet kyç dhe periudha e zbatimit

1. Hartëzimi i palëve të interesit	Fillimi: muaji 1	Përfundimi: muaji 2
Koordinatorët bashkiakë, me mbështetjen teknike nga LEAP, do të hartëzojnë të gjithë palët e interesit përkatëse në Lezhë dhe Vorë. Këtu përfshihen njësitë e qeverisjes vendore, organizatat me bazë komunitare, grupet e grave dhe të hatërojnë rinjve, bizneset turistike (hotele, restorante, operatorë turistikë), institucionet e trajnimit, zyrat e punës etj. Produkti do të jetë "Regjistri i palëve të interesit" që dokumenton rolin, kapacitetet dhe veprimtaritë aktuale të secilit aktor, që lidhen me punësimin ose turizmin.		
2. Vlerësimi i nevojave të komuniteti	Fillimi: muaji 2	Përfundimi: muaji 3
Do të zhvillohen një sërë diskutimesh me fokus grupe dhe intervistash me popullatat e synuara, duke përfshirë të rinj të papunë (meshkuj dhe femra veçmas), gra të punësuar më parë në fabrikat e veshjeve, pjesëtarë të komunitetit rom, persona me aftësi të kufizuara, si dhe me punëdhënës vendas. Këto seanca do të lehtësohen nga OJQ-të vendore ose këshillat rinorë në secilën bashki. Qëllimi është të identifikohen pengesat e perceptuara ndaj punësimit, boshllëqet në aftësi dhe idetë për zhvillimin vendor. Qasjet me ndjeshmëri gjinore do të sigurojnë që zërat e grave të dëgjohen në mënyrë të barabartë. Do të përpilohet një raport përmbledhës i vlerësimit të nevojave, duke theksuar nevojat prioritare dhe sugjerimet nga komuniteti.		
3. Inventari i aseteve turistike	Fillimi: muaji 1	Përfundimi: muaji 3
Paralelisht, zyrat bashkiake të turizmit/kulturës do të katalogojnë atraksionet turistike ekzistuese dhe potenciale në secilën zonë (site të trashëgimisë, atraksione natyrore, ngjarje kulturore, site agroturizmi). Ato do të bashkëpunojnë me historianë vendas dhe persona të moshuar të komunitetit për të siguruar edhe përfshirjen e atraksioneve më pak të njohura. Rezultati do të jetë një inventar i hartëzuar (duke përfshirë gjeo-etiketimin e siteve) që mund të informojë se ku mund të përqendrohen përpjekjet për zhvillimin e turizmit dhe trajnimit.		
4. Krijimi i partneriteteve	Fillimi: muaji 1	Përfundimi: muaji 3
Do të riaktivizohen MM-të mes AKPA-së, SHSSH-së, bashkive dhe do të shfrytëzohen rrjetet e informimit për të mbledhur informacione nga fshatra të largëta ose familje të marginalizuara që ndryshe mund të mos shprehen. Duhet të sqarohen rolet e OJQ-ve të ndryshme dhe ndërmarrjeve sociale në ofrimin e punësimit, zhvillimit të aftësive dhe shërbimeve e mbështetjes sociale, në mënyrë që përpjekjet të plotësojnë njëra-tjetrën dhe jo të përsëriten. Duhet të organizohen takime të rregullta koordinimi (të paktën çdo tre muaj) midis qeverisë bashkiake, drejtorit rajonal të AKPA-së, drejtorëve të shkollave të AFP-së dhe punëdhënësve kryesorë për të harmonizuar ndërhyrjet dhe për të pasuruar një komunitet të praktikave dhe profesionistëve.		

1.3. Përgjegjësitë

Partneri drejtues: AKPA-ja, në bashkëpunim me Bashkitë Lezhë dhe Vorë, do të emërojë për secilën bashki një koordinator vendor për të udhëhequr këtë Veprim. Koordinatorët do të jenë përgjegjës për mbledhjen e palëve të interesit dhe mbikëqyrjen e mbledhjes së të dhënave.

Partnerët përgjegjës:

- ▶ Zyrat vendore të punës dhe degët rajonale të AKPA-së duhet të ndihmojnë me identifikimin e pjesëmarrësve të papunë dhe të ofrojnë të dhëna mbi punëkërkesit e regjistruar.
- ▶ Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) si qendrat rinore, shoqatat e grave në Lezhë dhe Vorë duhet të mobilizojnë pjesëmarrësit për fokus grupet, veçanërisht nga komunitetet e marginalizuara (Linja 1 e shërbimit).
- ▶ Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe drejtoritë Bashkiake përgjegjëse për zbatimin e politikave të turizmit duhet të kontribuojë me ekspertizë për hartëzimin e aseteve turistike.
- ▶ LEAP-i (mbështetje teknike) do të ofrojë mjete për hartëzimin e palëve të interesit dhe trajnimin e lehtësuesve për kryerjen e vlerësimeve të nevojave; do të sigurojë metoda dhe dokumentacion gjithëpërfshirës.

1.4. Produktet e pritshme

- ▶ **Regjistri i palëve të interesit** që mbulon të paktën 50 aktorë kryesorë në të dyja bashkitë, me pika kontakti dhe fusha të identifikuara të kontributit.
- ▶ **Raporti i vlerësimi të nevojave** që përmbledh kontributet e komunitetit (me shtojca që i kategorizojnë reagimet sipas gjinisë dhe grupit), i cili do të orientojë hartimin e shërbimeve të trajnimit dhe punësimit në Veprimet pasuese.
- ▶ **Harta e aseteve turistike** (digjitale dhe e shtypur) që rendit të gjitha atraksionet e rëndësishme në Lezhë dhe Vorë, e cila do të përdoret në trajnimin për planifikimin (për guidat turistike etj.) dhe projektet e sipërmarrjes.
- ▶ 2 MM të nënshkruara nga partnerët vendorë.

Veprimi 2: Zgjerimi i trajnimit për aftësitë gjithëpërfshirëse për hotelerinë dhe turizmin

2.1. Objektivi dhe synimet

Synohet pajisja e individëve të papunë dhe të nënpunësuar në Lezhë dhe Vorë me aftësi specifike të nevojshme në hotelerinë, turizmin dhe sektorët e lidhur me to, duke përmirësuar kështu punësimin e tyre dhe duke kapërcyer hendekun e identifikuar nga punëdhënësit për aftësitë. Ky Veprim përqendrohet në ofrimin e programeve të trajnimit të orientuara drejt kërkesës, të cilat janë të arritshme për të rinjtë, gratë dhe grupet e tjera të disavantazuara, si dhe në forcimin e kapacitetit të ofruesve të trajnimit (publikë dhe privatë) për t'iu përgjigjur shpejt nevojave të tregut.

Të paktën **200 individë (50% gra)** përfundojnë trajnimin profesional ose për aftësitë në kuadër të këtij Veprimi brenda 9 muajve të parë. Trajnimet do të mbulojnë fusha të tilla si shërbimet e hotelierisë dhe restorantit (kamerierë, recepsion, pastrim), guidat turistike dhe interpretimi i trashëgimisë kulturore, artet kulinare, marketingu digjital për turizmin dhe prodhimi artizanal. Këto profile u konfirmuan gjatë konsultimeve. Minimumi prej 60% e të diplomuarve në trajnim pritet të sigurojnë punësim ose praktika të paguara brenda 3 muajve nga përfundimi. Përveç kësaj, të paktën 3 ofrues trajnimi jopublikë ose OJQ do të angazhohen për të ofruar kurse të shkurtra, duke zgjeruar rrjetin vendor të trajnimit. **(Linjat 1 dhe 2 të shërbimit)**

2.2. Veprimet kyç dhe periudha e zbatimit

1. Përshtatja e kurrikulës dhe mobilizimi i ofruesit	Fillimi: muaji 4	Përfundimi: muaji 12
Duke u bazuar në vlerësimin e nevojave (Veprimi 1) dhe kontributin e punëdhënësit, AKPA-ja dhe QFP-të publike do të përshtatin ose krijojnë kurrikula për kurset e shkurtra në fushat e identikuara të aftësive. Për shembull, mund të krijohet një kurs 3-mujor për "Asistent turizmi dhe hotelierie", duke kombinuar shërbimin bazë ndaj klientit, bazat e gjuhëve të huaja dhe njohuritë e turizmit në vend. Plani është të përfshihen OJQ-të dhe ofruesit privatë të trajnimit për të plotësuar shkollat publike të AFP-së: do të bëhet një thirrje e hapur për ofruesit e licensuar ose OJQ-të me përvojë për të propozuar kurse trajnimi që mund të ofrohen në nivel vendor në Lezhë ose Vorë. Ofruesit e përzgjedhur do të koordinojnë kurrikulat e tyre me AKAFPK-në për të siguruar njohjen (pjesëmarrësit mund të marrin certifikata).		
2. Mbulimi dhe përzgjedhja e pjesëmarrësve	Fillimi: muaji 2	Përfundimi: muaji 3
Duke përdorur kanalet e zgjeruara të mbulimit nga Veprimi 2, do të identifikohen kandidatët për kurset e ndryshme. Përparësi do t'u jepet të papunëve të regjistruar që plotësojnë kërkesat e kursit (niveli i arsimit, interesi) dhe sigurimit të balancës gjinore. Për kurse si trajnimi për guidat turistike, mund të synohen pjesëmarrësit më të rinj me aftësi gjuhësore; për kulinarinë ose mirëmbajtjen, mund të rekrutohen gra nga ish-fabrikat e veshjeve. Sidoqoftë, aspiratat e punëkërkuarve do të përcaktojnë rrugën e zgjedhur. Çdo kurs do të synojë një klasë me 15-20 pjesëmarrës. Të gjitha kurset së bashku do të arrijnë në 200 përfitues.		
3. Ofrimi i trajnimit	Fillimi: muaji 4	Përfundimi: muaji 10
Kurset do të ofrohen në vende të aksesueshme në bashki ose pranë tyre. Shkollat profesionale publike në qark (si shkolla profesionale në Lezhë ose ajo në Kamëz për Vorën) do të organizojnë disa trajnime, duke përdorur punishtet/kuzhinat e tyre etj., veçanërisht për aftësitë praktike në hotelieri. Kurse të tjera mund të zhvillohen në terren në biznese (p.sh., një hotel që ofron ambientet e tij për formim në punë, në rastin e stazhit) ose në qendra komunitare (për teori në klasë). Metodologjitë e trajnimit do të theksojnë të nxënit praktik të bazuar në kompetenca : p.sh.,		

praktikantët në artet kulinarë do të bëjnë praktikë në kuzhinat e restoranteve (siç janë partneritetet me restorante si Mrizi i Zanave ose hotelet në Shëngjin), ndërsa ata që merren me guida do të praktikohen duke organizuar ture të vërteta në vend. Oraret e trajnimit do të jenë fleksible (opsione në mbrëmje ose me kohë të pjesshme) për t'iu përshtatur grave me fëmijë ose personave të tjerë që nuk mund të marrin pjesë me kohë të plotë. Për financimin e këtyre programeve, do të përdoren QFP-të publike, si dhe dy programe të AKPA-së, përkatësisht programi i Praktikës Profesionale dhe Programi i Punësimit me Subvencion.

4. Certifikimi dhe gjetja e vendit të punës	Fillimi: muaji 10	Përfundimi: muaji 12
Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata. Këshilluesit e zyrës së punës (nga Veprimi 2) dhe trajnuesit do të bashkëpunojnë për gjetjen e vendit të punës: duke organizuar takime midis të diplomuarve dhe punëdhënësve vendas, duke i ftuar punëdhënësit në vlerësimet përfundimtare të kursit etj. Gjithashtu, disa të trajnuar mund të lidhen me mbështetje për sipërmarrjen (Veprimi 4) nëse parapëlqejnë të hapin biznesin e tyre të vogël ose veprimtarinë e tyre të pavarur duke përdorur aftësitë e tyre të reja (për shembull, guidat e certifikuara mund të krijojnë një ndërmarrje të vogël turistike).		

2.3. Përgjegjësitë

Partneri drejtues: AKPA-ja, konkretisht sektori i saj i programeve të AFP-së dhe trajnimit, në partneritet me AKAFPK-në për mbikëqyrjen e kurrikulës. AKPA-ja do të menaxhojë thirrjen për ofruesit e trajnimit dhe do të sigurojë standardet e cilësisë në ofrimin e trajnimit. Gjithashtu, mund të alokojnë fonde për trajnim (duke përdorur potencialisht buxhetin e shtetit ose fondet e donatorëve nga Programi i Përbashkët) për të subvencionuar këto kurse, në mënyrë që ato të jenë falas për pjesëmarrësit.

Partnerët përgjegjës:

- ▶ Qendra rajonale e AFP-së në Lezhë dhe shkollat profesionale në afërsi (përfshirë ato në Tiranë/Durrës) do të ofrojnë trajnues ose ambiente sipas nevojës. Instruktorët e tyre mund të angazhohen me kohë të pjesshme për të dhënë mësim kurse.
- ▶ OJQ-të dhe ofruesit privatë të trajnimit, si **Instituti Neranxi** (për trajnim kulinar), HAP HAT, institucionet private arsimore, OJQ-të vendore me përvojë në trajnimin për turizmin ose artizanatin, mbase edhe **Shoqata Shqiptare e Turizmit** (SHSHT) për të ndihmuar me standardet e trajnimit për guidat turistike. Këta partnerë do të kontraktohen për të ofruar kurse specifike dhe për të angazhuar ekspertë të industrisë.
- ▶ Hotelet, restorantet, agjencitë turistike në Lezhë dhe Vorë do të kontribuojnë duke ofruar vende pune për praktika, duke dhuruar materiale (disa hotele mund të lejojnë përdorimin e sallës së tyre të konferencave për leksione etj.) dhe duke punësuar të diplomuarit. Mund të ngrihet një bord këshillimor i punëdhënësve për të këshilluar lidhur me programet e trajnimit (sinergia e Linjës 2 të Shërbimit).
- ▶ LEAP-i do të ofrojë asistencë teknike për të përsheptuar zhvillimin e kurrikulës, ndoshta do të financojë pagesa për praktikantët (për të mbuluar transportin ose kujdesin ndaj fëmijëve gjatë trajnimit) dhe do të monitorojë kriteret e përfshirjes (duke siguruar që grupet e cënueshme të përfitojnë vërtet).

2.4. Produktet e pritshme

- ▶ Portofoli i programeve të trajnimit që përbëhet nga të paktën 5 kurse të veçanta. Krijimi i kurrikulave dhe materialeve të trajnimit të detajuara për secilin prej tyre.
- ▶ Trajnimi i 200 individëve të papunë ose të nënpunësuar, me një minimum prej 100 grash dhe një përfaqësim të përshtatshëm të minoriteteve dhe personave me aftësi të kufizuara (janë siguruar ambiente trajnimi të aksesueshme). Është krijuar një bazë të dhënash për të diplomuarit, duke përfshirë kualifikimet e tyre të reja.
- ▶ Të paktën 120 nga 200 të diplomuar (60%) sigurojnë punësim, praktikë pune ose nisin një veprimtari gjeneruese të ardhurash brenda 3 muajve pas trajnimit. Kjo do të gjurmohet nga zyrat e punës. Historitë e suksesit do të dokumentohen.

Veprimi 3: Forcimi i shërbimeve të këshillimit për karrierën dhe punësimin

3.1. Objektivi dhe synimet

Synohet rritja e kalimit të sendërgjia rinjve dhe punëkërkuesve në trajnim dhe punësim duke përmirësuar këshillimin për karrierën që në një fazë të hershme dhe duke përmirësuar shërbimet vendore të punësimit. Ky Veprim institucionalizon ndërhyrjen e hershme (në shkolla) dhe rrit kapacitetet e zyrave të punës për të ofruar shërbime të përqendruara te klienti, duke synuar veçanërisht të rinjtë dhe gratë që janë larg tregut të punës.

Vënia në zbatim e programeve të edukimit për karrierën në të gjitha **shkollat e arsimit të mesëm të ulët** në Lezhë dhe Vorë (të paktën 10 shkolla gjithsej) duke arritur afërsisht 1000 nxënës (50% vajza) në vitin e parë. Regjistrimi i 200 të rinjve të tjerë joaktivë ose të papunë (50% gra) në zyrat e punës përmes fushatave të informimit. Trajnimi i 10 punonjësve (këshillues/specialistë punësimi) në metodat e përmirësuara të këshillimit për karrierën dhe menaxhimit të rasteve. (Linjat 1 dhe 2 të shërbimit)

3.2. Veprimet kyç dhe periudhat e zbatimit

1. Këshillimi për karrierën në shkolla	Fillimi: muaji 4	Përfundimi: muaji 12
Në koordinim me Ministrinë e Arsimit, moduli i orientimit në karrierë do të zbatohet për nxënësit e klasave të 8-ta dhe të 9-ta në bashkitë e synuara. Kjo do të përfshijë hartimin e kurrikulave të thjeshta të këshillimit për karrierën dhe trajnimin e këshilluesve në shkolla ose të mësuesve të caktuar për të ofruar seanca mbi alternativat profesionale, prirjet e tregut vendor të punës (duke theksuar mundësitë në turizëm/hoteleri krahas të tjerave) dhe aftësitë plotësuese. Profesionistët vendas (p.sh., menaxherë hotelesh, sipërmarrës të suksesshëm) do të ftohen në ditët e karrierës në shkollë për të frymëzuar nxënësit. Objektivi është të përcillet ndërgjegjësimi për drejtimet e AFP-së dhe planifikimin modern të karrierës që në moshë të re.		
2. Ngritja e kapaciteteve për stafin e zyrës së punës	Fillimi: muaji 2	Përfundimi: muaji 3
AKPA-ja do të organizojë një program trajnimi për stafin e zyrës së punës në Lezhë dhe zyrës së punës në Tiranë/Vorë. Temat do të përfshijnë teknikat e shtrirjes së veprimtarive për të angazhuar të rinjtë dhe gratë NEET (p.sh. vizita derë më derë, mbulim në mediat sociale), këshillim dhe profilizim individual të punëkërkuesve dhe strategji të angazhimit të punëdhënësve. Stafi do të mësojë të përdorë mjete digjitale të përditësuara për përpunimin e vendeve të punës dhe menaxhimin e rasteve.		

3. Fushata e mbulimit dhe regjistrimit	Fillimi: muaji	Përfundimi: muaji
Pas trajnimit të stafit, Zyrat e Punës do të zhvillojnë një fushatë proaktive në të dyja bashkitë. Kjo mund të përfshijë "ditët e hapura" vendore ose panaireset e pune në qendrat komunitare, angazhimin e ekipeve të lëvizshme në zonat rurale dhe qytetet e vogla, si dhe partneritetin me OJQ-të vendore për të arritur te personat e papunë të paregjistruar. Qëllimi është të identifikohen dhe regjistrohen punëkërkuarët e rinj, veçanërisht të rinjtë që kanë mbaruar shkollën, por nuk punojnë dhe as nuk ndjekin studimet, si dhe gratë që kanë braktisur tregun e punës. Çdo i regjistruar i ri do të orientohet lidhur me shërbimet e disponueshme (oferta trajnimi, këshillim, programe MATP si subvencione page ose skema praktikash).		
4. Shërbimet e përmirësuara të këshillimit për karrierën	Fillimi: muaji	Përfundimi: muaji
Zyrat e punës do të prezantojnë shërbime të përmirësuara këshillimi dhe përputhjeje të punës: çdo punëkërkuar të regjistruar nga grupet e synuara i caktohet një këshillues i cili e ndihmon të hartojë një plan individual punësimi. Për të rinjtë, kjo mund të përfshijë referimin për trajnime (të lidhura me programet e Veprimit 3); për gratë e papuna, lidhjen me mundësitë e ritrajnimit ose punësimit (Veprimi 3 dhe 4); për të tjerët, ofrimin e informacionit mbi mbështetjen për vetëpunësimin (Veprimi 4). Zyrat do të krijojnë edhe kënde informacioni të dedikuara për vendet e punës në sektorin e turizmit, duke i informuar klientët rreth natyrës së vendeve të punës në hoteleri, aftësive të kërkuara dhe rrugëve të përparimit (kjo adreson çështjen e mungesës së informacionit rreth karrierave në turizëm). Diskutimet me Bashkinë Vorë do të përqendrohen në hapjen e një zyre punësimi në ambientet e Bashkisë Vorë.		

3.3. Përgjegjësitë

Partneri drejtues: AKPA-ja përmes Drejtorive Rajonale të Punës në Lezhë dhe Tiranë (për Vorën). AKPA-ja do të koordinojë trajnimin e stafit dhe do të mbikëqyrë zbatimin e shërbimeve të reja, në përputhje me standardet kombëtare për ofrimin e shërbimeve të punësimit.

Partnerët përgjegjës:

- ▶ Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (së shpejti) do të sigurojnë që orientimi për karrierën në shkolla të jetë i integruar dhe të ofrojë mbështetje për kurrikulat; Drejtoritë vendore të Arsimit lehtësojnë pjesëmarrjen e shkollave.
- ▶ Zyrat Bashkiake të Arsimit dhe ofruesit e arsimit do të ndihmojnë në zbatimin e veprimtarive në shkollë, për të rregulluar logjistikën dhe miratimet me drejtorët e shkollave.
- ▶ OJQ-të/Organizatrat rinore vendore do të ndihmojnë me ngjarjet e informimit dhe do të asistojnë në identifikimin e të rinjve NEET (për shembull, qendrat rinore mund të mobilizojnë vullnetarë për të gjetur bashkëmoshatarë që janë joaktivë).
- ▶ LEAP-i do të vërë në dispozicion ekspertë teknikë për të hartuar trajnime për stafin e zyrave të punës dhe për të hartuar instrumente për këshillimin për karrierën. Gjithashtu, ai mund të ofrojë materiale fillestare (postera, fletëpalosje) për fushatën e informimit (mbështetje për Linjën 1 të Shërbimit).

3.4. Produktet e pritshme:

- ▶ Të paktën 10 shkolla zbatojnë një modul për këshillimin për karrierën dhe hartohet një raport i shkurtër që dokumenton orët mësimore dhe përshtypjet e nxënësve (për ta zgjeruar potencialisht programin në të ardhmen).
- ▶ Dhjetë punonjës të zyrës së punë (këshillues, ndërmjetës pune) përfunduan me sukses programet për forcimin e kapaciteteve, vërtetuar nga certifikatat dhe performanca e përmirësuar (e monitoruar nëpërmjet AKPA-së).
- ▶ Në zyrat e punës janë regjistruar 200 punëkërkuar të rinj nga grupet e synuara; është krijuar një bazë të dhënash e profileve të tyre për ndjekje.
- ▶ Janë vënë në zbatim procedura të reja këshillimi dhe përputhjeje me punën. Zyrat e punës do të hartojnë raporte tremujore mbi rezultatet e mbulimit dhe gjetjes së punës, duke treguar një rritje të numrit të vendeve të lira të punës të mbledhura nga punëdhënësit në turizëm dhe sektorë të tjerë (si një tregues për përmirësimin e angazhimit të punëdhënësve).
- ▶ Përmirësime të vogla në mjediset e zyrës së punës (si është përcaktimi i një hapësire për informacion mbi karrierën ose pajisja me një njësi të lëvizshme për mbulim në terren) të arritura nëpërmjet rialokimit të burimeve ose granteve të vogla. Këto përmirësime mbështesin ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve të përmirësuara përtej afatit kohor të projektit.

Veprimi 4: Promovimi i sipërmarrjes gjithëpërfshirëse dhe zhvillimit të bizneseve të turizmit

4.1. Objektivi dhe synimet

Synohet të stimulohet krijimi i vendeve të punës nga ana e kërkesës duke mbështetur zhvillimin e bizneseve të reja dhe ekzistuese në turizëm dhe zinxhirët e vlerave përkatëse (agroushqimor, artizanat, transporti). Ky Veprim fuqizon sipërmarrësit vendas, veçanërisht të rinjtë dhe gratë dhe, lehtëson formalizimin dhe rritjen e ndërmarrjeve mikro që mund të krijojnë vende pune për të tjerët. Gjithashtu, përfshin krijimin e produkteve dhe përvojave turistike të bazuara në komunitet që shfrytëzojnë asetet vendase dhe përfshijnë drejtpërdrejt banorët vendas.

Duhet të mbështeten **të paktën 15 sipërmarrës ose nisma të ndërmarrjeve mikro** (individë ose grupe) për të hapur ose zgjeruar bizneset. Kjo do të përfshijë një përzierje të: bizneseve të reja (synohen 5 biznese të reja të udhëhequra nga të rinj ose gra), zgjerimit të bizneseve ekzistuese familjare në NVM formale (synohen 5 biznese, p.sh.. bujtina familjare ose ferma që shtojnë shërbimet turistike). Përveç kësaj, të zhvillohen dhe pilotohen **3 produkte të reja turistike me bazë komunitetin** (si një tur i udhëhequr për eksplorimin e shpellave në Vorë, një shteg i trashëgimisë kulturore në Lezhë dhe një festival ushqimor ose panair artizanal vendas). Këto përpjekje synojnë të gjenerojnë rreth 30 vende të reja pune (përfshirë vetëpunësimin) dhe të formalizojnë punën informale (me të paktën 10 punëtorë informalë ekzistues të kaluar në punësim formal). **(Linjat 2, 3, 4 dhe 5 të shërbimit)**

4.2. Veprimet kyç dhe periudha e zbatimit

1. Trajnimi dhe mentorimi për sipërmarrjen	Fillimi: muaji	Përfundimi: muaji
Duke u bazuar në interesin e identifikuar gjatë Veprimeve të mëparshme (shumë pjesëmarrës të fokus grupeve ose trajnimeve mund të kenë ide biznesi), do të vihet në zbatim Programi i Vetëpunësimit. Ai do të përbëhet nga një workshop trajnimi intensiv 5-ditor mbi planifikimin e biznesit, njohuritë financiare dhe menaxhimin, i përshtatur posaçërisht për turizmin dhe shërbimet.		

Pjesëmarrësit: deri në 25 sipërmarrës aspirantë ose ekzistues nga të dyja bashkitë (të paktën 50% gra). Ata do të zgjidhen përmes një aplikimi dhe do të kenë përparësi ata që propozojnë biznese që punësojnë ose u sjellin përfitime personave të tjerë në nevojë (për shembull, një shoqatë bashkëpunimi për gratë² që prodhon ushqime tradicionale për shitje, ose një startup për të rinj, që ofron shërbime turistike që punësojnë guida vendore).		
2. Zhvillimi i biznesit dhe qasja në financim	Fillimi: muaji 4	Përfundimi: muaji 12
Pas trajnimit, sipërmarrësit do të përmirësojnë planet e tyre të biznesit me mentorët. Ekipi i Udhërrëfyesit, në koordinim me AKPA-në dhe bashkitë, do t'i ndihmojë ato të lidhen me mundësitë e financimit. Kjo mund të përfshijë: lehtësimin e aplikimeve për programet kombëtare të granteve për vetëpunësim (programi i Vetëpunësimit), organizimin e granteve të vogla nga projekti ose donatorët dhe lidhjen me institucionet e mikrofinancimit ose bankat për kredi të vogla. Bashkitë mund të alokojnë edhe një fond ose mbështetje në natyrë (për shembull, duke siguruar një hapësirë publike për një treg artizanale ose një ndërtesë të papërdorur për të ngritur një qendër informacioni turistik të drejtuar nga një shoqatë). Deri në muajin 12, synohet që të paktën 10 nga bizneset e mbështetura të kenë marrë një formë financimi ose mbështetjeje me pajisje për t'u vënë në zbatim ose për t'u zgjeruar.		
3. Krijimi i produktit turistik me bazë komunitare	Fillimi: muaji 4	Përfundimi: muaji 12
Duhet të nxitet krijimi i përvojave të reja turistike të udhëhequra nga komunitetet vendase dhe grupet e marginalizuara, duke i shndërruar ato në përfitues të drejtpërdrejtë të rritjes së sektorit. Në praktikë, bashkitë duhet të lehtësojnë dhe bashkëfinancojnë hartimin e produkteve turistike, të tilla si: ture me guidë nga komuniteti (si ture historike në këmbë në qytetin e vjetër të Lezhës të udhëhequra nga të rinj vendas të trajnuar, ose ecje në natyrë në fshatrat përreth Vorës të udhëhequra nga fermerët vendas), ngjarje dhe festivale kulturore (ringjallja e traditave vendore, kuzhinës, muzikës si atraksione), panaire artizanale dhe ushqimore (ku artizanët u shesin produkte turistëve) dhe mbrëmje rrëfimi historik (ku të moshuarit ndajnë legjendat e vendit me vizitorët). Lezha, me historinë e saj të pasur, mund të prezantojë një program për "Shtigjet e Trashëgimisë" që lidh vende si Memoriali i Skënderbeut dhe Kalaja e Lezhës me rrëfime nga guidat e komunitetit. Vora mund të përqendrohet në agroturizëm dhe të hapë ferma që banorët e qytetit të përjetojnë jetesën rurale ose të paraqesë vreshtarinë/punishtet e verës në vend. Grupeve të komunitetit ose OJQ-ve mund t'u ofrohen grante të vogla ose asistencë teknike për t'i zbatuar këto ide, për të krijuar plane biznesi dhe për t'i pilotuar ato. Për shembull, një OJQ mund të ndihmojë një grup grash rome në Lezhë të hapin një punishte suvenieresh artizanale që lidhet me ture ose të ndihmojë një grup të rinjsh në Vorë të krijojnë një biznes turesh çiklizmi. Produkti do të jetë prezantimi i të paktën 3 produkteve turistike gjithëpërfshirëse nga komuniteti.		
4. Rrjetëzimi dhe krijimi i lidhjeve	Fillimi: muaji 1	Mbyllja: muaji 12

² Ligji nr. 38/2012 rregullon shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, duke përcaktuar themelimin, funksionimin dhe qeverisjen e tyre si organizata vullnetare që synojnë të përmbushin nevojat ekonomike dhe të prodhimit të anëtarëve në bujqësi dhe blegtori.

Për t'i mbështetur këto ndërmarrje dhe produkte, Veprimi 4 do të lehtësojë krijimin e të paktën dy rrjeteve formale ose joformale: njëri mund të jetë një **rrjet vendor i turizmit** në Lezhë (hotele, bujtina, guida turistike, artizanë, të gjithë të lidhur për të koordinuar promovimin e turizmit, mundësisht si pjesë e bashkisë ose dhomës së tregtisë) dhe tjetri mund të jetë një **klub punëdhënësish në hoteleri** në zonën industriale të Vorës (punëdhënës që angazhohen të punësojnë punonjës vendas dhe të marrin pjesë në trajnime). Gjithashtu, grupet e prodhuesve mund të formalizohen në shoqëri bashkëpunimi bujqësor ose shoqëri bashkëpunimi reciprok³: p.sh., prodhuesit e mjaltit ose artizanët e Lezhës krijojnë një shoqatë për të tregtuar së bashku produktet e tyre të turistët dhe dyqanet. Do të ofrohet mbështetje ligjore për regjistrimin e këtyre subjekteve nëse është e nevojshme (Linja 5 e shërbimit). Deri në fund të vitit, këto rrjete duhet të veprojnë aktivisht dhe të bashkëveprojnë me qeverisjen vendore (disa përfaqësues do të jenë pjesë e Komitetit Drejtues të Udhërrëfyesit për të vazhduar dialogun).

4.3. Detyrimet

Partnerët drejtues: Bashkia Lezhë dhe Bashkia Vorë (Njësitë Vendore të Zhvillimit Ekonomik) do të bashkë-udhëheqin këtë veprim, pasi ato kanë interes të drejtpërdrejtë në promovimin e rritjes së bizneseve vendase dhe të turizmit. Ato do të koordinojnë programin e sipërmarrjes (ndoshta përmes zyrave të tyre vendore të mbështetjes së biznesit ose qendrave të shërbimit të përbashkët, nëse ekzistojnë) dhe do të marrin përsipër organizimin e ngjarjeve komunitare (si festivale). Gjithashtu, ato menaxhojnë çdo kontribut bashkiak (grante të vogla ose asete për përdorim).

Partnerët përgjegjës

- ▶ Shoqata Shqiptare e Turizmit (SHSHT) dhe Dhomat Rajonale të Tregtisë për të ofruar ekspertizë për trajnimin e sipërmarrësve, mentorimin dhe lidhjen e bizneseve të reja me tregje më të gjera ose platforma kombëtare të promovimit të turizmit. Gjithashtu, ato mund të ndihmojnë në gjykimin e konkurseve për planet e biznesit.
- ▶ AKPA-ja duhet të përafrojë grantet vendore me programin kombëtar sipas VKM-së për Vetëpunësimin për mbështetjen e bizneseve të reja dhe të sigurojë që kandidatët nga Lezha/Vora të aplikojnë.
- ▶ Institucionet e mikrofinancimit/bankat dhe organizatat e mikrokredive në Shqipëri do të ftohen në seanca informuese me sipërmarrësit, për të ofruar produkte kredie të përshtatura sipas nevojave (Linja 4 e shërbimit: qasja në financim).
- ▶ OJQ-të me fokus në Zhvillimin e Ndërmarrjeve që kanë përvojë në krijimin e kooperativave ose projekteve të zinxhirit të vlerave (si ato në bujqësi ose artizanat) mund të kontraktohen

³ Ligji nr. 38/2012 rregullon shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, duke përcaktuar themelimin, funksionimin dhe qeverisjen e tyre si organizata vullnetare që synojnë të përmbushin nevojat ekonomike dhe të prodhimit të anëtarëve në bujqësi dhe blegtori. Ligji nr. 9747/2007 mbulon shoqëritë e bashkëpunimit reciprok, duke u përqendruar në përfitimet e ndërsjella ekonomike dhe sociale për anëtarët përmes veprimtarive kolektive dhe shërbimeve të përbashkëta. Të dyja ligjet përcaktojnë kuadrin ligjor për organizimin e brendshëm, organet vendimmarrëse, përgjegjësitë financiare dhe mbikëqyrjen shtetërore të këtyre subjekteve bashkëpunuese.

për të lehtësuar formimin e kooperativave në sektorin e agropërpunimit ose artizanatit në Lezhë.

- ▶ LEAP-i për të mbështetur zbatimin e PATP-ve për të siguruar mbështetje të menjëhershme për sipërmarrjet më premtuese (Linja 4 e shërbimit). Gjithashtu, ato do të ndihmojnë në vendosjen e monitorimit për krijimin e vendeve të punës nga këto ndërmarrje.

4.4. Produktet e pritshme

- ▶ 20-25 pjesëmarrës (nga të cilët të paktën 50% janë gra) përfundojnë programin e trajnimit dhe mentorimit për programin e Vetëpunësimit.
- ▶ Deri në fund të Veprimit, **5 startup-e të reja** janë regjistruar në fusha si shërbimet e guidave turistike, dyqanet e artizanatit ose kateringut për turistët.
- ▶ Janë pilotuar tre produkte/ngjarje të reja turistike komunitare.
 - Një tur me guidë ose veprimtari në natyrë (me të paktën 2 ture provë të kryera dhe vlerësime të marra; guida vendore të trajnuara dhe të gatshme për të vazhduar ofrimin).
 - Një ngjarje kulturore ose kulinare (festival ose panair) në secilën bashki (me të paktën 500 pjesëmarrës secili, duke përfshirë vendasit dhe vizitorët), ku prezantohet kultura vendase; prodhuesit raportojnë shitjet/të ardhurat nga pjesëmarrja.
 - Rrjeti i bujtinave/ambienteve të qëndrimit (të paktën 3 shtëpi të listuara që presin vizitorë deri në fund të vitit; lista e kontrollit të standardeve të cilësisë e përgatitur për ambientet e qëndrimit).

Secili prej këtyre projekteve pilot do të prodhojë një raport të shkurtër ose një studim rasti, i cili mund të përdoret për t'i rafinuar dhe institucionalizuar ato si oferta të rregullta.

Veprimi 5: Shfrytëzimi i fondeve dhe infrastrukturës për rritjen e turizmit gjithëpërfshirës

5.1. Objektivi dhe synimet

Synohet sigurimi dhe shfrytëzimi i fondeve të jashtme dhe mjeteve të investimeve publike për të përmirësuar infrastrukturën vendore dhe mjedisin e favorshëm për zhvillimin e turizmit gjithëpërfshirës. Ky Veprim siguron që nismat e filluara sipas Udhërrëfyesit të kenë burime të mjaftueshme dhe që barrierat fizike ose sistematike (infrastruktura, objektet, mbështetja e politikave) të adresohen duke përdorur programet qeveritare dhe të donatorëve të dedikuara për zhvillimin rajonal, turizmin dhe punësimin.

Duhet të përgatiten dhe dorëzohen **të paktën 3 propozime financimi** (të përbashkëta mes bashkive dhe partnerëve) të burimet kombëtare ose ndërkombëtare të financimit deri në muajin 12, duke synuar sjelljen e investimeve shtesë prej të paktën 20 milionë lekësh (afërsisht 247.000 dollarë) për projekte vendore. Zbatimi i **2 projekteve të infrastrukturës me bazë komunitare** që mbështesin drejtpërdrejt punësimin (për shembull, përmirësimi i një siti turistik vendas ose krijimi i një Qendre Komunitare Shumëfunksionale (ekipe ndërfunksionale për punësim, trajnim dhe shërbime sociale). Duhet të advokohet për mbështetje politike në mënyrë që programet kombëtare përkatëse (si **Fondi i Investimeve në Turizëm sipas Ligjit 30/2024** ose skema të ngjashme) t'u japin përparësi Lezhës dhe Vorës në buxhetet e tyre 2025–2026. (Linjat 4 dhe 5 të shërbimit)

5.2. Veprimet kyç dhe periudha e zbatimit

1. Identifikimi i mundësive për financim	Fillimi: muaji 1	Përfundimi: muaji 12
Zyrat bashkiake të promovimit të kulturës dhe turizmit do të shqyrtojnë thirrjet e ardhshme për financim dhe burimet e buxhetit. Mundësitë kryesore përfshijnë: grantet e Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e turizmit (të mundësuar nga Ligji 30/2024), programet e nxitjes së punësimit, grantet e delegacionit të BE-së ose të donatorëve për zhvillimin ekonomik në vend dhe programet për infrastrukturën për punësim. Një grup i vogël pune do të ngrihet në zyrën e projekteve të secilës bashki për t'u përqendruar në mbledhjen e fondeve.		
2. Përgatitja e propozimit të projektit	Fillimi: muaji 2	Përfundimi: muaji 12
Idetë konkrete të projektit nga Veprimet 1-4 do të formulohen në propozime. <u>Shembuj</u> : në Lezhë, një projekt për përmirësimin e infrastrukturës turistike (si përmirësimi i aksesit rrugor dhe sinjalistikës drejt Kalasë së Lezhës, ose ndërtimi i një qendre ekspozitash artizanale); në Vorë, një projekt për krijimin e një Qendre Trajnimi Profesional dhe Inovacioni duke përdorur një godinë publike ekzistuese, ku mund të zhvillohen kurse të vazhdueshme dhe të krijohet një hapësirë pune për sipërmarrësit e rinj. Këto propozime do të theksojnë modelin e bashkëfinancimit dhe partneritetit (meqenëse nëpërmjet Udhërrëfyesit ekziston puna bazë dhe bashkinvestimi). Konsulentët ose ekspertët nga LEAP-i do të ndihmojnë në hartimin e propozimeve për t'u siguruar që ato përmbushin kërkesat e donatorëve.		
3. Dorëzimi dhe advokimi	Fillimi: muaji 2	Përfundimi: muaji 12
Propozimet do të dorëzohen në kanalet përkatëse të financimit. Njëkohësisht, do të zhvillohet advokim i nivelit të lartë: takime me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Financave/Ekonomisë për të promovuar përfshirjen e projekteve të Lezhës dhe Vorës në programet kombëtare; duke shfrytëzuar praninë e Programit të Përbashkët të OKB-së për të tërhequr vëmendjen e donatorëve. Kryetarët e bashkive Lezhë dhe Vorë, së bashku me përfaqësues të komunitetit (përfshirë drejtueset nga projekti), do të prezantojnë arritjet e Udhërrëfyesit dhe nevojat për hapat e mëtejshëm në këto forume për të siguruar mbështetje.		
4. Zbatimi fillestar i projekteve të financimit	Fillimi: muaji 12	Përfundimi: vazhdon pas 12 muajsh
Idealisht, nga muaji 12, të paktën një propozim i jepet drita jeshile (për shembull, jepet një grant për projekt komunitar). Veprimi do të mbikëqyrë më pas fillimin e atij projekti: p.sh., tenderimin e një kontraktori për të instaluar panele informacioni turistik dhe shtigje të aksesueshme në një sit trashëgimie, ose ngritjen e Qendrës Shumëfunktionale me pajisje. Ndërkohë që zbatimi i plotë mund të shtrihet përtej vitit të parë të këtij Udhërrëfyesi, fillimi i këtyre projekteve siguron përmirësime në infrastrukturë ose sistem që forcojnë përfitimet e Veprimeve 1-4 (siç është një qendër që ofron vazhdimisht trajnime dhe kujdes për fëmijët, duke u ofruar grave më shumë mundësi për trajnime dhe punësim). Do të përcaktohen plane monitorimi në mënyrë që Komiteti Drejtues i Udhërrëfyesit të vazhdojë t'i ndjekë veprimtaritë përtej fazës fillestare.		

5.3. Përgjegjësitë

Partnerët drejtues: Bashkitë Lezhë dhe Vorë, veçanërisht njësitë e tyre të zhvillimit të projekteve, do të udhëheqin në hartimin e propozimeve dhe koordinimin me ministritë kombëtare. Mbështetja politike e kryetarëve të bashkive është thelbësore në advokimin për financim. Gjithashtu, do të menaxhojnë çdo zbatim të projektit të infrastrukturës në nivel vendor (prokurim, mbikëqyrje).

Partnerët përgjegjës:

- ▶ Ministria e Kulturës, Turizmit, Sporteve dhe Rinisë (së shpejti), e cila është thelbësore për financimin e infrastrukturës turistike. Do të marrë propozime për përmirësime të siteve dhe mund të alokojë fonde ose ekspertizë teknike (p.sh., nëpërmjet Agjencisë së Zonave të Mbrojtura për sitet ekologjike, ose Ministrisë së Kulturës për vendet e trashëgimisë, sipas nevojës).
- ▶ Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (së shpejti) / Agjencia Kombëtare e Zhvillimit Rajonal: mund të kanalizojnë fondet e punëve publike ose fondet e zhvillimit rajonal për të mbështetur projekte që krijojnë vende pune (si rinovimi i një tregu, përmirësimi i një rruge që të çon në një vend agroturizmi sipas një skeme punimesh që kërkon punë intensive dhe mundëson punësimin e punonjësve vendas).
- ▶ Mund të bëhen thirrje për skemat e granteve të zhvillimit vendor të BE-së ose donatorëve të tjerë dypalësh. Ata do të angazhohen për udhëzime e ndoshta edhe si bashkëfinancues. LEAP-i mund të vazhdojë të luajë rol lehtësues.
- ▶ Rrjeti i turizmit dhe grupet komunitare nga Veprimi 4 do të kontribuojnë duke përcaktuar nevojat dhe ndoshta duke u angazhuar me kontribute nga komuniteti (punë në natyrë ose angazhime mirëmbajtjeje, të cilat forcojnë propozimet). Për shembull, një komunitet mund të angazhohet për të mirëmbajtur një treg të ri nëse ndërtohet. Nëse propozimet përfshijnë nisma të integruara punësimi dhe sociale (si qendër shumëfunktionale komunitare, që ofron kujdes dhe trajnim për fëmijët), agjencitë përkatëse do të jenë partnere në planifikimin dhe drejtimin e tyre, duke siguruar përputhshmëri me standardet kombëtare të shërbimit.

5.4. Produktet e pritshme

- ▶ Të paktën tre propozime të cilësisë së lartë u paraqiten burimeve të identifikuar të financimit. Çdo propozim është në përputhje me kriteret e financimit dhe përfshin objektivat e qartë, buxhetet dhe ndikimin e pritshëm (vende pune, përfitues).
- ▶ Objektivi prej 20 milionë lekësh në angazhime të reja financimi. Kjo mund të arrihet përmes një granti të madh ose disa granteve më të vogla. Nëse deri në fund të vitit miratohet financimi, do të raportohen shumat. Edhe nëse vendimet do të jenë në pritje, do të ketë një sërë projektesh me vlerën e kësaj shume për zbatim në vitin 2026.
- ▶ Evidencat e një harmonizimi më të madh mund të përfshijnë: Shtimin e Lezhës/Vorës nga MTM-ja në listën e saj të prioritetëve për mbështetjen e zhvillimit të turizmit; alokimin e buxhetit shtesë nga AKPA-ja për trajnime vitin e ardhshëm duke parë suksesin; ose drejtimin nga Ministria e Infrastrukturës të një pjesë të një programi për rrugët rurale për të përmirësuar aksesin në një fshat turistik të identifikuar nga Udhërrëfyesi. Në thelb, programet kryesore fillojnë të pasqyrojnë nevojat e identifikuar nga ky Udhërrëfyes.
- ▶ **Nismat e infrastrukturës kanë filluar:** Fillojnë dy projekte konkrete:
 - **Projekti i përmirësimit të aksesit në Kalanë e Lezhës.** Deri në fund të vitit, projekti ka filluar ndërtimin e një shtegu për vizitorët dhe ndriçimin në kështjellë (me punësimin e të papunëve vendas për disa punë, duke u lidhur me MATP-të).
 - **Qendra e aftësive dhe shërbimeve komunitare në Vorë.** Godina e bashkisë do të jetë rinovuar dhe pajisur me dy klase trajnime dhe një kënd kujdesi për fëmijë, gati për të organizuar kurse dhe për t'u mundësuar nënave të marrin pjesë (kjo mund të financohet nga një grant donatori për barazinë gjinore). Ndonëse përfundimi mund të bëhet më vonë, vetë fillimi është tregues suksesi.

4. Masat e zbatimit

Zbatimi i këtij Udhërrëfyese do të mbështetet nga PP-ja LEAP i OKB-së. Do të përdorën të njëjtët mekanizma drejtues për monitorimin e zbatimit dhe ofrimin e udhëzimeve për të ecur përpara. Për t'u siguruar se të gjitha ndërhyrjet janë të efektshme dhe burimet janë përdorur siç duhet, është thelbësore të krijohet një kuadër i fortë **Monitorimi dhe Vlerësimi (MV)**. Rekomandohet të krijohet një njësi ose ekip i dedikuar për koordinimin e MV-së që mund të veprojë në nivel bashkiak.

- ▶ **Treguesit Kyç të Performancës (TKP-të)** janë përcaktuar tashmë për secilën prej shtyllave.
- ▶ **Raportimi i rregullt** është thelbësor. Përmes një raporti publik vjetor dhe një paneli kontrolli tremujor për vendimmarrësit mund të ruhet transparenca.
- ▶ Të mësuarit përmes **Komuniteteve të Praktikave** nxit kulturën e të nxënësve, që do të thotë se palët e interesit reflektojnë rregullisht mbi të dhënat dhe mësojnë si nga sukseset ashtu edhe nga dështimet.

Shtojca 1. Përmbledhja e veprimeve

Në tabelën e mëposhtme jepe një përmbledhje e të gjitha Veprimeve sipas Udhërrëfyesit Lezhë-Vorë, duke përfshirë objektivin bazë, rezultatet kryesore të synuara, afatin kohor dhe përgjegjësinë kryesore:

Veprimi	Objektivi	Synimet kyç (deri në fund të vitit 1)	Partnerët drejtues
1	Të angazhohen palët e interesit dhe të mbledhen informacione për nevojat për planifikim gjithëpërfshirës. Të krijohen partneritete vendore për punësim.	- Plotësimi i hartës së palëve të interesit (mbi 50 aktorë). - Konsultimi i 100 individëve të cënueshëm; përgatitja e raportit të vlerësimit të nevojave. - Përgatitja e inventarit të aseteve turistike (hartëzimi i të gjitha siteve kryesore).	Bashkitë Lezhë dhe Vorë (Koodinatorët vendorë); Mbështetja: OSHC-të, Zyrat e Punës
2	Të përmirësohet kalimi nga shkolla në punë dhe të rriten kapacitetet e shërbimeve vendore të punësimit për të kontaktuar dhe mbështetur grupet e synuara.	- Zbatimi i këshillimit për karrierën në 10 shkolla (u kontaktuan 1000 nxënës). - Regjistrimi i 200 të rinjve/grave NEET në Zyrat e Punës. - Trajnimi i 10 punonjësve të punësimit; vënia në zbatim e shërbimeve të reja të mbulimit.	AKPA-ja (Zyrat e Punës), MAS, MEI; Mbështetja: Zyrat arsimore, OJQ-të rinore
3	Të ofrohen trajnime të nxitura nga kërkesa për të rinjtë dhe gratë e papuna për vende pune në hoteleri, turizëm dhe fusha të ngjashme.	- Përfundimi i kurseve të trajnimit për 200 individë (50% gra). - Krijimi i më shumë se 5 kurrikulave të reja për kurse të shkurtra. - Angazhimi i 3 ofruesve jopublikë të trajnimit.	AKPA-ja dhe AKAFPK-ja; Mbështetja: Qendrat e AFP-së, institutet private (p.sh., Neranxi), punëdhënësit (për praktika)
4	Të mbështeten bizneset e vogla/ekzistuese, startup-et, kooperativat në turizëm dhe zinxhirët vendorë të vlerave për krijimin e vendeve të punës. Krijimi i produkteve turistike me bazë komunitare.	- Mbështetja e 15 sipërmarrësve/grupeve (trajnim dhe mentorim për biznesin). - Prezantimi i 5 startup-eve të reja - Pilotimi i 3 nismave komunitare (ture, festivale, ambiente qëndrimi).	Bashkitë (Njësitë e zhvillimit ekonomik vendor) dhe SHSHT-ja/Dhoma; Mbështetja: AKPA-ja (Programi i vetëpunësimit), OJQ-të (mbështetje për sipërmarrjet), institucionet e mikrofinancimit
5	Të sigurohen fonde të jashtme dhe të zbatohet	Dorëzimi i 3 propozimeve për financim (të synohen 20 milionë lekë gjithsej).	Bashkitë (Njësitë e Projekteve); Mbështetja: MTM-ja; MEI; partnerët

	infrastruktura/projektet që mundësojnë turizëm dhe punësim të qëndrueshëm.	• Fillimi i 2 projekteve të infrastrukturës vendore (përmirësimi i siteve turistike, qendra e trajnimit/shërbimeve etj.). • Angazhimi i burimeve shtesë për vitin 2026 (integrimi në programet kombëtare).	donatorë (BE), Komiteti Drejtues i Udhërrëfyesit
--	--	---	--

